



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Sigurinë Kombëtare

PROCESVERBAL

Tiranë, më 21.05.2019, ora 10:00

Drejton mbledhjen:

Ermonela Felaj - kryetare e Komisionit

Rendi i ditës :

Shqyrtim i Projektligjit “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995 “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar””.

Marrin pjesë:

Ermonela Felaj, Myslim Murrizi, Alban Zeneli, Elena Xhina, Sadi Vorpsi, Luan Duzha, Anduel Xhindi, Luan Harusha, Antoneta Dhima, Edmond Rrushi, Paulin Sterkaj, Lefter Maliqi dhe Xhemal Qefalia.

Mungojnë:

Elona Hoxha dhe Ylli Shehu.

Të ftuar:

Ulsi Manja - kryetar i Komisionit të Ligjeve,

Adnor Shameti - anëtar i Komisionit të Ligjeve

HAPET MBLEDHJA

Ermonela Felaj – Mirëmëngjesi të gjithëve!

Fillojmë mbledhjen e Komisionit për Sigurinë Kombëtare. Në rendin e ditës së kësaj mbledhjeje kemi diskutimin dhe miratimin në parim të shtesave dhe propozimeve të bëra në Kodin Penal të Republikës së Shqipërisë, që në fakt përfaqësojnë një ligj të vitit 1995.

Kujtoj për të gjithë kolegët e komisionit se këto ndryshime në Kodin Penal janë propozuar nga një grup deputetësh të maxhorancës. Për këtë arsye ne kemi dy kolegë të Komisionit të Ligjeve që janë edhe firmëtarë të këtyre propozimeve, të cilët do të na bëjnë prezantimin në parim të propozimeve që do të bëhen në Kodin Penal.

Janë 22 nene, përjashtoj nënin që i takon hyrjes në fuqi të ligjit, që mendohet t'i shtohen Kodit Penal, duke bërë të mundur reflektimin e disa problemeve që tashmë janë të evidentuara në praktikën gjyqësore, por që ndeshen me vakuumin ligjor ose me një dënim të papërshtatshëm që nuk i përgjigjet më nevojës që kemi për të parandaluar kryerjen e tyre, por njëkohësisht për t'i ndëshkuar sa dhe si duhet ata.

Do t'i kaloj menjëherë fjalën kolegut, zotit Ulsi Manja. Edhe zoti Shameti mund të shtojë diçka nëse do të ketë nevojë. Më pas fjala do të jetë për kolegët për të bërë pyetje. Dua të them se edhe unë jam firmëtare e këtyre ndryshimeve.

Zoti Manja, fjala është për ju.

Ulsi Manja – E nderuar zonja kryetare e Komisionit të Sigurisë,

Të nderuar kolegë deputetë,

Sot, bashkë me kolegun, zotin Shameti në emër të 11 kolegëve të maxhorancës jemi këtu për të prezantuar një paketë shumë të rëndësishme të ndryshimeve në Kodin Penal, të cilat janë bërë të njohura edhe për opinionin publik, por sot fillon shqyrtimi dhe miratimi në parim i kësaj pakete, për t'i hapur më pas rrugën miratimit të këtyre ndryshimeve në seancë plenare.

Ju e theksuat në fjalën tuaj se kjo paketë ndryshimesh në Kodin Penal synon të plotësojë një vakuum, që ka aktualisht Kodi Penal si për sa u përket veprave të reja, ashtu edhe ndryshimit të masave të dënimit për një pjesë tjetër, por më lejoni të sjell në vëmendjen e kolegëve të këtij komisioni se cila ishte domosdoshmëria e këtyre ndryshimeve në Kodin Penal dhe cili është qëllimi, që kërkohet të arrihet me këto ndryshime.

Domosdoshmëria për amendimet në Kodin Penal për disa çështje synon të marrë në mbrojtje me garanci shtesë mbrojtjeje juridiko-penale veprat penale që cenojnë prishjen e rendit dhe të sigurisë publike, dhunën në shëndetësi, dhunën në aktivitetet sportive, dhunën ndaj funksionarëve publikë apo të zgjedhur. Referuar ngjarjeve të muajve të fundit, siç e dini kemi pasur një shtim të dhunës ndaj profesionistëve shëndetësorë, po ashtu edhe në aktivitete sportive, por edhe një shtim të dhunës ndaj punonjësve të policisë, pse jo edhe kundër të zgjedhurve apo funksionarëve publikë. Parashikimet aktuale në Kodin Penal rezultojnë se nuk garantojnë siç duhet parandalimin për veprimet e dhunës. Dispozitat përkatëse në Kodin Penal për dënimin e këtyre fenomeneve ose kanë mangësi ose sanksionojnë dënime të lehta ose këto dënime nuk ekzistojnë fare.

Me qëllim dënimin e çdo veprimi dhune dhe parandalimin e dhunës në shoqëri në tërësi, propozohet ashpërsimi i dënimeve për vepra penale të dhunës ndaj punonjësve të policisë, mjekëve, sportistëve, arbitrave, ndërmjetësve sportivë, trajnerëve, funksionarëve publikë dhe të zgjedhurve apo atyre që shërbejnë në shërbimin publik, si edhe përfshirja e veprave të reja penale për adresimin e duhur të çështjeve të dhunës, si akte që ngarkojnë me përgjegjësi penale.

Nevoja për ndryshime në Kodin Penal për çështjet për mbrojtjen e të drejtës së autorit që është edhe një tjetër ndryshim, vjen si pasojë e debatit të gjerë publik për rritjen e ndërgjegjësimin të shoqërisë kundër kopjimeve apo përdorimeve të padrejta të veprave të të tjerëve. Në Kodin Penal ka disa parashikime për mbrojtjen e pronësisë intelektuale apo riprodhimin e padrejtë të veprës së tjetrit, por dispozitat nuk janë të plota për sa i takon mbrojtjes së të drejtës së autorit dhe dënimet përkatëse nuk i përgjigjen realitetit. Me qëllim parandalimin e këtyre fenomeneve shqetësuese për shoqërinë, paketa e ndryshimeve në Kodin Penal që ne propozojmë sot për miratimin në parim para këtij komisioni të nderuar nuk mbaron vetëm me këto vepra penale. Janë edhe 2 krerë shumë të rëndësishëm të Kodit Penal, ku propozohet të ketë ndryshime dhe konkretisht kanë të bëjnë me sigurinë ushqimore dhe sigurinë mjedisore.

Lidhur me sigurinë mjedisore më lejoni të nderuar kolegë, të sjell në vëmendjen tuaj se ndryshimi që ne propozojmë për sigurinë mjedisore ka të bëjë me transfuzimin e plotë të një direktive të vitit 2008 të BE-së, që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, me masa penale, pra nëpërmjet ligjit penal, është ekzaktësisht direktiva përkatëse e BE-së.

Lidhur me sigurinë ushqimore, ju e dini problematikën që ne kemi me sigurinë dhe garancinë e produkteve ushqimore që sot janë në treg dhe konsumohen nga konsumatorët

shqiptarë. Kodi Penal, për hir të së vërtetës në drejtim të sigurisë ushqimore ka pasur vetëm një dispozitë, edhe ajo ishte një dispozitë e bardhë që më tepër referonte në legjislacionin dytësor. Në këtë drejtim u pa e domosdoshme që në kreun që ka të bëjë me veprat penale, të cilat marrin në mbrojtje sigurinë ushqimore të kemi edhe shtimin e disa dispozitave të reja.

Përpara se të futem te ndryshimet dhe të bëj prezantimin e tyre në drejtim të parashikimeve konkrete në Kodin Penal, më lejoni të sjell në vëmendjen e kolegëve se kjo paketë është hartuar si rezultat i një konsultimi të gjerë edhe me aktorë dhe faktorë të tjerë që kanë propozuar ndryshimet.

Kolegia Felaj e tha që jemi një grup deputetësh të PS-së që nga pikëpamja e Rregullores së Kuvendit kemi formalizuar depozitimin e nismës, por jo vetëm kaq, një pjesë e kolegëve firmëtarë që janë edhe juristë kanë qenë të përfshirë drejtpërdrejt në konsultimin publik dhe diskutimin e kësaj pakete, por pjesë përbërëse e hartimit të paketës kanë qenë edhe ministrët e linjës, si: Ministria e Shëndetësisë, e cila ka bërë nëpërmjet grupit të saj të punës propozimet konkrete lidhur me dispozitat përkatëse, që propozohen për sigurinë mjekësore. Ministria e Mjedisit që ka qenë propozuesja direkte e paketës së ndryshimeve, të cilat kanë të bëjnë me krimet mjedisore, ka qenë Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë dhe disa ekspertë të fushave përkatëse. Kemi të bëjmë me një paketë të mirëkonsultuar për të ardhur në variantin që ne kemi paraqitur në komision.

Ka pasur diskutime të gjata, nëse do të vinim me një paketë ndryshimesh siç kemi ardhur apo këto ndryshime do të jenë pjesë e grupit të punës që po punon për hartimin e një Kodi të ri Penal? Por nisur nga aktualiteti i ngjarjeve, por edhe i problematikave që kanë lindur për sa i përket sigurisë së jetës dhe të shëndetit, sigurisë ushqimore, sigurisë mjedisore, sigurisë publike dhe sigurisë mjekësore ne vendosëm të vijmë me këtë paketë. Ku konsiston ajo?

Siç e tha edhe zonja Felaj projektligji ka 23 nene, ku neni 23 ka të bëjë me hyrjen në fuqi të ligjit. Ndryshimet prekin pjesën e përgjithshme dhe pjesën e posaçme të Kodit Penal. Duke u nisur nga struktura që ka Kodi Penal ndërhyhet në 5 krerë, nga të cilët 1 kre i përket pjesës së përgjithshme të Kodit Penal dhe 4 krerë i përkasin pjesës së posaçme. Po ashtu preken edhe 5 seksione sipas krerëve përkatës: preket seksioni V i kreut të dytë, seksioni II dhe X i kreut të tretë të Kodit Penal, seksioni I dhe III i kreut të tetë,. Preken në total 29 dispozita të Kodit Penal, në 12 prej tyre ndryshohen apo shtohen paragrafë të rinj, përfshirë edhe ndryshimet e masave të dënimit. Ndërsa 17 dispozita të shpërndara sipas krerëve dhe seksioneve shtohen tërësisht të reja.

Fushat ku ndërhyhet me masa penale, u theksua në fillim, i referohen sigurisë së jetës dhe shëndetit, sigurisë ushqimore, sigurisë mjedisore, sigurisë publike dhe sigurisë mjekësore.

Këtu dua ta ndërpres fjalën time në lidhje me këtë prezantim të ndryshimeve në Kodin Penal. Nuk e di nëse ka ndonjë gjë për të shtuar kolegu Shameti, por jemi të hapur për pyetjet e kolegëve.

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Manja për parashtrimin në mënyrë të përmbledhur! Nuk e di nëse zoti Shameti kërkon t'i shtojë diçka parashtrimit tuaj.

Adnor Shameti - Faleminderit, zonja kryetare!

Drafti i paraqitur nga ana e një grupi deputetësh të PS-së vjen natyrshëm si një ndryshim që kërkohet sot në Kodin Penal për arsye të ndryshimit të kushteve ekonomiko-shoqërore, si dhe të situatës së rendit, të sigurisë në vend. Nuk dua të heq asnjë presje nga analiza shtruese që bëri zoti Manja, por dua t'ju ftoj të gjithëve që me votën tuaj të kalojmë këtë nismë ligjore, pasi shihet e domosdoshme për kushtet aktuale të vendit.

Ermonela Felaj - Faleminderit!

Në fakt, ne për fatin e mirë, në këtë komision, edhe në Komisionin e Ligjeve, jemi në shumicë juristë, kemi qenë edhe praktikues të ligjit penal dhe besoj se një diskutim i hapur do të na ndihmojë në përmirësimin e paketës. Normalisht kanë qenë disa propozues, disa firmëtarë dhe duhet që të njësohet e gjitha me të njëjtën gjuhë, me të njëjtën strukturë, e cila duhet të përputhet në vetvete edhe me strukturën aktuale të Kodit Penal. Kodi Penal përfaqëson një ligj të cilësuar, duke qenë i tillë është shumë e rëndësishme që çdo gjë që shkruhet në atë ligj të jetë jetëgjatë në kohë dhe jo jetëshkurtër. Ndërhyrjet e shpeshta gjithmonë kanë sjellë probleme edhe në praktikë, edhe në kuptimin, zbatimin e drejtë të dënimit për veprat të ndryshme penale.

Le t'i lëmë vend hapjes së diskutimit, për të kuptuar se ku janë gjërat që mund të reflektohen ndryshe, më mirë ose mund të ketë edhe vepra të tjera penale të cilat nuk janë përfshirë ndër këto propozime dhe që meritojnë të kenë një adresim.

Fjala është për ju kolegë.

Po, zoti Murrizi. Pastaj fjalën e ka zoti Qefalia.

Myslim Murrizi - Faleminderit, zonja kryetare!

Duke dëgjuar fjalën përmbyllëse të kolegut Manja që tha se është një grup pune, i cili po bën ndryshimin e Kodit Penal në tërësi, dua të di se cila është arsyeja e ngutjes për të bërë këto arnime, përderisa do të bëhet një Kod i ri Penal?

E dyta, shikoj në relacionin shpjegues disa germa deri te germa “zh” ku shprehen arsyet pse kërkohen këto amendamente. Pra, 22 nene të ndryshuara të Kodit Penal janë: mbrojtja nga dhuna e profesionistëve, mbrojtja nga dhuna e Policisë së Shtetit, rendi është futur si pikë e tretë apo e katërt (në relacionin shpjegues kolegu Manja e paraqiti si pikë të parë), mbrojtja nga dhuna në sport, mbrojtja nga kafshimi i qenve, mbrojtja nga zhurmat e muzikës së lokaleve dhe e fundit është bllokimi i qarkullimit rrugor, që nuk e kuptoj se për çfarë bllokimi bëhet fjalë, pasi është shumë përciptazi.

Dua të di, për disa nene konkrete që i kishit vënë në relacionin shpjegues, cili është ndryshimi mes asaj që sot parashikon Kodi Penal dhe ndryshimeve të reja që na keni dërguar? Për shembull, në nenin 7 thoni: “Burg 2-7 vjet për faunën dhe florën”. Nuk e di, por ju keni 5-6 vjet si maxhorancë që për hatër të mbjelljes së pyjeve me kanabis keni bllokuar edhe gjuetinë e rosave, u bënë kaq vjet. Për çfarë faune dhe flore bëhet fjalë, kur këtu po vrasin në mes të bllokut 100 metra nga ne dhe kur të gjithë ata që u akuzuan në pamjen e parë nga policia, nga mediet, nga politika si vrasës kanë dalë jashtë.

Ju thoni po të vrasësh një çërrlu, apo një pelikan kaçurrel në Divjakë që e kishte merak Donald Lu-ja, do të futesh 7 vjet në burg. “Goditje për shkak të detyrës”, cili është ndryshimi? Unë e di që në Kodin Penal është një nen për goditjen për shkak të detyrës. Sa ka qenë dhe sa është bërë?

Neni 14 që keni sjellë ju për “zhurmën dhe muzikën” dënohet deri 2 vjet burg. Duhet të fusim tani në burg të gjithë gërnetaxinjtë që dalin në rrugë, Verllapën apo sazet që vijnë vërdallë? M’u kujtua filmi “Koncert në vitin ‘36”: “Burg kush rreh kafshët në pazar, burg ai që bënte aheng me çiniët për t’ua prishur dyzenin atyre që kishin ardhur nga Tirana.”

Kur pashë nismën tuaj për ndryshime në Kodin Penal, meqenëse ju thoni se do të ketë një kod të ri pas kësaj, prisja që të kishte ashpërsime realisht për ato akte, vepra kriminale, fenomene negative që cenojnë shoqërinë shqiptare në vitet e fundit, padashur të bëj politikë në qeverisjen e PS-së apo të PD-së, përfshirë trafikun, implikimin e zyrtarëve, të funksionarëve të lartë të shtetit dhe drejtuesve të policisë. Kemi 4 komisarë policie sot në kërkim, që bënin sekserin për të shitur drogë dhe për të pastruar administratën e lartë edhe politikën shqiptare nga njerëz, të cilët vazhdojnë të lihen sa me gomone, sa me tragete, sa me avionë, nga mushkonjat në Divjakë, në Gjadër të Lezhës dhe më gjerë. Prisja, meqenëse

bëhen ndryshime në Kodin Penal, meqenëse në Komisionin për Reformën Zgjedhore kërkohet edhe ashpërsim i Kodit Penal nga maxhoranca, nga zoti Balla, por edhe nga bashkëkryetari i këtij komisioni, zoti Gjikhuri për shitblerjen e votës. Pra, në fund të fundit aty fillon shitblerja e pushtetit, por shikoj se nga 22 nene, 17 nene i keni bërë për rosat, sazexhinjtë dhe nuk e di se çfarë tjetër. Një nen i fundit që është evaziv, po keni kurajë, thoni drejtë: “Do të ndalojmë protestat në rrugë!”. Ai nen i bllokimit, nuk e di, me çfarë, me blloqe betoni, me saurrel, me tanke, me diagaç? Ka ndodhur në vitin '97 kur bandat pushtuan Shqipërinë dhe tanket mbetën rrugëve. Protestat nuk besoj se do të mund t'i ndaloni 29 vjet pas rrëzimit të komunizmit.

Ermonela Felaj - Zoti Murrizi, mendoj se mund ta shikojmë me një sy tjetër, por gjithmonë nëse zoti Manja do të mund t'i sqarojë ato. Nuk jemi në diskutimin nen për nen, por t'ju sqaronte në mënyrë të ndarë se ku janë propozuar ndryshimet dhe pse janë propozuar ato.

Ulsi Manja - Faleminderit, zonja kryetare!

Kolegu Murrizi bëri shumë pyetje dhe shpresoj t'u jap përgjigjen e duhur atyre, edhe pse një pjesë e pyetjeve kanë të bëjnë me debatin që do t'i nënshtrohet projektligji kur të vijmë për shqyrtimin dhe miratimin nen për nen, por gjithsesi do të mundohem t'i grupoj përgjigjet për pyetjet e bëra.

Që në fillim të prezantimit të paketës zonja Felaj e tha se Kodi Penal është i vitit 1995 dhe dinamika e jetës shoqërore në Shqipëri ka ecur shumë përpara, ndërkohë që kemi një Kod Penal të vitit 1995, i cili është ndryshuar herë pas herë, por që ka ardhur koha të kemi një Kod të ri Penal, por Kodi i ri Penal është reformë shumë e thellë. Nuk është e lehtë që në një hark kohor të shkurtër të adresosh punën në drejtim të një Kodi të ri Penal, pasi kërkon kohën e tij, diskutimin e tij, por edhe konsultimin e duhur publik, si edhe transparencën e duhur.

Ju pyesni pse nuk pritët që këto shqetësime apo këto problematika që kërkonin t'i adresoni me këtë paketë në Kodin Penal, të bëheshin pjesë e hartimit të Kodi të ri Penal? Për dy arsye.

E para, Kodi i ri Penal, siç e thashë kërkon një kohë relativisht të gjatë për t'u finalizuar dhe për të ardhur në Kuvend.

E dyta, paketa e masave që ne propozojmë reflekton edhe ndryshimet që ka pësuar legjislacioni në Shqipëri. Për shembull, edhe detyrimet ndërkombëtare që kemi në lidhje me përafrimin e legjislacionit me BE-në. Po marr ndryshimet që ne propozojmë në lidhje me të

drejtën e autorit, kemi një kuadër të ri ligjor, Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar ligjin “ Për të drejtën e autorit” dhe natyrisht këto ndryshime që ka pësuar legjislacioni do të duhen reflektuar edhe në Kodin Penal.

Ju e dini se një nga ligjet më të rëndësishme që ne votuam si Kuvend, ka qenë mbyllja e lojërave të fatit dhe të bixhozit në Shqipëri.

Pra, praktikisht, ndryshimi që pësoi ligji “Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë”, patjetër që duheshin reflektuar edhe në Kodin Penal. Sepse kishim një dispozitë në Kodin Penal, por tani pas hyrjes në fuqi të ligjit kemi një realitet tjetër.

Kjo është arsyeja që ne i reflektuam këto ndryshime.

Arsyeja tjetër: veprat penale kundër mjedisit. E kemi detyrim që buron nga procesi i integritetit. Është një direktivë e Bashkimit Europian, e cila do të duhej të ishte transfuzuar me kohë në Kodin Penal. Madje, në raportin e Bashkimit Europian për vitin 2016 ka qenë e shprehur në mënyrë eksplicite, se Shqipëria nuk po e reflekton si duhet në Kodin Penal direktivën e Bashkimit Europian, që ka të bëjë me mbrojtjen e mjedisit, florës dhe faunës.

Sepse, i nderuar koleg, sot çështjet e sigurisë ushqimore e të mjedisit shihen si çështje të lidhura ngushtësisht me sigurinë kombëtare. Në pamje të parë, duket sikur mjedisi dhe siguria ushqimore apo çështjet e konsumit ushqimor janë dytësore, por në fakt, sot trendi i legjislacioneve moderne në Bashkimin Europian, por jo vetëm kaq, i ka nxjerrë këto problematika në plan të parë, për sa i përket mbrojtjes që i bëjnë.

Mjedisi dhe ushqimi janë vepra penale, të cilat vrasin çdo ditë nga pak. Adresimin e këtyre problematikave dhe marrjen në mbrojtje nëpërmjet masave penale, unë e konsideroj gjënë e duhur dhe në momentin e duhur.

Ju thatë se përse po ashpërsohen? A nuk kemi ne në kodin penal një dispozitë që ka të bëjë me goditjen për shkak të detyrës, dhe ku është ndryshimi?

Po, është e vërtetë, ne e kemi në Kodin Penal goditjen për shkak të detyrës, kemi edhe kanosjen për shkak të detyrës, por ne si maxhorancë, pra grupi nismëtar i këtyre ndryshimeve, kërkon që një kategori të caktuar të zyrtarëve publikë apo të nëpunësve publikë, t’u japë një mbrojtje juridiko-penale të posaçme. Këtu kemi veçuar punonjësit e Policisë së Shtetit, profesionistët shëndetësorë, si dhe funksionarët publikë. Ndërsa për gjithë kategorinë tjetër të zyrtarëve, aktualisht Kodi Penal ka nenin 237, që është goditja për shkak të detyrës.

E gjithë kategoria e nëpunësve publikë dhe e zyrtarëve gëzon mbrojtje juridiko-penale nëpërmjet nenit 237, ndërsa ndryshimet veçojnë vetëm këtë kategori të nëpunësve

publikë, të zyrtarëve apo funksionarëve publikë. Ndryshimet si subjekte të posaçme. Patjetër që ndryshime kanë edhe masat e dënimit. Pra, në këtë drejtim janë ashpërsuar edhe masat e dënimit.

Ju pyetët: përse në paketën e ndryshimeve të Kodit Penal, që propozoni, nuk keni parashikuar ndërhyrjet në kreun e ka të bëjë me sistemin e zgjedhjeve të lira e demokratike në Shqipëri?

E kemi theksuar edhe më parë, se ky kapitull që ka Kodi ynë Penal sot, është i plotë në drejtim të garantimit të zgjedhjeve të lira e të sistemit demokratik në Shqipëri. Ndoshta është bërë pak e njohur për publikun paketa aktuale që ka Kodi Penal, por në ditët në vazhdim, gjë që sigurisht është edhe një detyrim që e ka edhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, për shkak të Kodit Zgjedhor, që t'ia bëjë të qartë e të njohur opinionit publik: paketa që ka Kodi Penal, për sa i përket garantimit dhe mbrojtjes juridiko-penale të zgjedhjeve të lira dhe sistemit demokratik në Shqipëri është e plotë, dhe është konsideruar që nuk ka nevojë për masa të tjera shtesë nëpërmjet Kodit Penal.

E fundit lidhet me një nen, i cili ka të bëjë me pengimin e qarkullimit të mjeteve të transportit. Në mos gaboj, kjo ishte pyetja konkrete, që kishte të bënte me faktin nëse ky ndryshim në Kodin Penal ka ardhur për shkak të protestave të opozitës.

I nderuar koleg, më lejo të jem i drejtpërdrejt në përgjigje të kësaj pyetjeje!

Neni 293, që parashikon pengimin e qarkullimit të mjeteve të transportit, është në Kodin Penal. Sot që flasim është në Kodin Penal.

Çfarë ndryshimi propozojmë ne në këtë nen? Ju do ta diskutoni edhe kur të vini në shqyrtimin nen për nen. E para ka të bëjë me një saktësi dhe qartësi ligjore të aplikimit në praktikë të kësaj dispozite. Është e paaplikueshme sot, sepse në mënyrë kumulative kërkon vendosjen e pengesave dhe ndalimin me çdo mjet a çdo mënyrë të qarkullimit të mjeteve të transportit automobilistik.

Ndryshimi ynë heq fjalën “dhe”, e thotë: “vënia e pengesave ose ndalimi”.

Pra, nga pikëpamja e aplikimit në praktikë nesër, në punën e përditshme të agjencive të ligjzbatimit, e këtu e kam fjalën për prokurorinë, nuk kërkohet parashikimi në mënyrë kumulative i të dy kushteve, për të qenë vepër penale. Lidhur me masën e dënimit, mbetet po e njëjta: gjobë ose burgim deri në tre vjet.

Personalisht, e këtu po flas në cilësinë e deputetit, që kur të vi në Komisionin e ligjeve apo edhe në komisionet e tjera, të cilat janë përfshirë në diskutimin e kësaj pakete si komisione për dhënie mendimi, kam edhe propozimin tim konkret. madje, këtë propozim po

e bëj edhe këtu, para Komisionit të Sigurisë, gjithnjë nëse do të merret në konsideratë nga ana juaj.

Edhe në variantin që është sot në Kodin Penal, me gjithë ndryshimin që ne propozojmë me këtë saktësim ligjor, unë do të kërkoja që dispozita të kishte një riformulim tjetër, për të bërë dallimin mes kategorive të rrugëve.

Nuk është njëloj dhe s'ka pse të dënohet njëloj, bllokimi i një aksi nacional rrugësh, që janë nyje shumë nevralgjike në jetën e përditshme të komunitetit, me bllokimin e një rruge e cila, sipas standardeve që ne kemi sot për rrugët, është klasifikuar rrugë dytësore.

Pra, duhet bërë dallimi edhe për sa i përket kategorizimit të rrugëve, dhe në varësi të kategorizimit të rrugëve të bëhet edhe përshkallëzimi i masës së dënimit. Mund të mbetet me dy-tre paragrafë, mund të jetë me gjobë dhe në nivelin e një kundërvajtjeje penale të bllokimit apo vënies së pengesave në rrugët dytësore. Me burg duhet të jetë vetëm në rastet ku bllokohen akset nevralgjike për jetën shoqërore, por pse jo edhe që lidhen me akse të cilat, le të themi, afektojnë sigurinë kombëtare. Pse? Sot nuk është normale të bllokohet një aks nacional, e për rrjedhojë të bllokohen qytetarët, të cilët kanë probleme me spitalet, kanë probleme me shkollat e fëmijëve, kanë probleme me bizneset e tyre, si dhe kanë probleme të jetës së përditshme.

Në një sistem demokratik, e drejta e tubimit është e lirë, është e lirë e drejta e protestës, por po kaq të rëndësishme janë edhe garantimi i lirive për pjesën tjetër të njerëzve, të cilët kërkojnë të vazhdojnë me normalitetin e jetës së përditshme.

Prandaj, unë do të propozoja kolegëve të komisionit, që nëse do të ishte e mundur, gjatë fazës së shqyrtimit dhe diskutimit nen për nen, pikërisht nenin 293, që ne e kemi propozuar, ta shohin edhe në këndvështrimin e një riformulimi të kësaj dispozite.

Nuk e di nëse pyetjet e kolegut Murrizi morën përgjigje.

Edhe diçka të fundit. Unë nuk ndaj të njëjtin mendim me kolegun Murrizi, se edhe laguna e Divjakës meriton po kaq vëmendje, që të mbrohet me masa juridiko-penale, sa dhe një kategori...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, për njerëzit Kodi ynë Penal mund të jetë një ndër kodet penale, që e merr në mbrojtje në mënyrë shembullore jetën dhe shëndetin e njeriut në Republikën e Shqipërisë. Madje, ne kemi vepra penale për sa i përket jetës dhe shëndetit, me masa të ashpra dënimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Është çështje tjetër zbatimi i Kodit Penal, është çështje tjetër Kodi Penal në vetvete.

Këtu dua ta mbyll: edhe mjedisi, edhe flora e fauna e egër, sidomos speciet e veçanta që ne kemi në Lagunën e Divjakës, meritojnë vëmendje të posaçme.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Manja!

Fjala për zotin Qefalia.

Xhemal Qefalia – Faleminderit, zonja kryetare!

Faleminderit, zoti Manja, zoti Shameti, si dhe të gjithë ju firmëtarët, që keni bërë të mundur një draft kaq të dobishëm.

Në fakt, do ta cilësoja që në fillim, se kjo ka qenë një domosdoshmëri, pasi ne parlamentarët, si ligjvënës, rendim më tepër për të hartuar ligje që të jenë në përputhje me standardet europiane, dhe bëjmë mirë. Ardhja në këtë moment e këtij drafti ligjor është një gjë shumë pozitive, pasi ka të bëjë me një sensibilitet të madh të opinionit të gjerë shoqëror.

Besoj, zoti Manja, se për shqetësimin e dhunën që ushtrohet ndaj mjekëve, ndaj sportit, ndaj mjedisit, ndaj sigurisë ushqimore, janë të interesuar të gjithë kolegët, si të maxhorancës, ashtu edhe të opozitës. Madje do të thosha se duke e filluar këtë nismë pikërisht te Komisioni i Sigurisë, ju bëni gjënë më të mirë, pasi i gjithë drafti, i gjithë ligji në tërësi shkon në sigurinë publike, në rritjen e sigurisë kombëtare publike.

Në këtë kuadër, është gjë shumë pozitive. Ju e thatë se ka pasur një farë angazhimi për të sensibilizuar, e madje për të marrë kontakte me grupet e interesit ne i kemi parë kontaktet që janë bërë me mjekët, me drejtuesit në fushën sportive. Nuk e di sa është realizuar kjo me përfaqësues të mjedisit nga ministria përkatëse, apo jo. Gjithsesi, mbetet në kuadrin e një pyetjeje kjo që thashë.

Gjëja në lidhje me të cilën doja të pyesja konkretisht, zoti Manja, si profesionist dhe si kryetar i Komisionit të Ligjeve, është: ju e dini se ky është një ligj që kërkon 84 vota. Në këtë kuadër – këtë e kam edhe vërejtje, por edhe ën formë pyetjeje për juve – a është tentuar për të pasur një farë dakordësie edhe me përfaqësues të opozitës, të cilët dakordësohen në lidhje me këtë pjesë? Pyetja e dytë kjo.

Pyetja e tretë. Ne në Komisionin e Sigurisë, por edhe në Komisionin e Ligjeve, para disa kohësh jemi ndeshur edhe me një kërkesë, madje në formën e një referendumi, lidhur me mbrojtjen e kafshëve, e me këtë rast mendoj se ju kujtohen edhe pamjet e tmerrshme që kemi parë të shfaqura në Komisionin e Ligjeve. A nuk është gjykuar që të ketë edhe një nen, në të cilin të jenë reflektuar disa nga sugjerimet që bri shoqëria civile në lidhje me këtë çështje?

I bindur se kjo nismë është shumë e mirë dhe aktuale, do të pritet me shumë interes nga grupet e interesit, por edhe nga mbarë opinioni shoqëror. Po ashtu, jam i bindur se do të gjejë edhe dakordësinë e kolegëve të opozitës.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Qefalia!

Po, zoti Manja!

Ulsi Manja – Shumë faleminderit për pyetjet, zoti Qefalia!

Unë do t'ju jap një përgjigje shumë të shkurtër dhe të qartë pyetjeve që ju adresoni. Për sa i përket konsultimit, po, paketa është konsultuar me të gjitha ministrinë e linjës, të cilat kanë propozuar ndryshime: me Ministrinë e Brendshme, me Ministrinë e Shëndetësisë, me Ministrinë e Mjedisit. Patjetër që Ministria e Drejtësisë ka qenë e përfshirë në diskutimin e kësaj pakete, por paketa ka qenë e hapur ndaj sugjerimeve edhe nga kolegë e ekspertë që kanë ekspertizë dhe njohuri në fushën e ligjit penal.

Paketa që ka të bëjë me dhunën në sport, ka qenë pjesë e një tryeze që ka organizuar Kryeministri me Federatën Shqiptare të Futbollit. Paketa që propozohet për mjekësinë ka qenë pjesë e një konsultimi dhe diskutimi të hapur publik me profesionistët e shëndetësisë. Edhe paketa që ka të bëjë me dhunën ndaj zyrtarëve ka qenë pjesë e këtij konsultimi. Sa i takon Ministrisë së Bujqësisë e të ushqimit, për të cilën ju falënderoj që më dhatë mundësinë të flas, se nuk e përmenda gjatë prezantimit tim, Ministria e Bujqësisë dhe e Ushqimit e AKU-ja, pra Agjencia Kombëtare e Ushqimit, ka qenë propozuesja e paketës që ka të bëjë me sigurinë ushqimore.

Ndërkohë, lidhur me mosparashikimin e një dispozite konkrete, që ka të bëjë me mbrojtjen e kafshëve, më lejoni të sjell në vëmendjen e kolegëve të komisionit, që kjo nismë, e cila është edhe nismë e qytetarëve, tashmë është në Komisionin e Ligjeve si iniciativë ligjvënëse më vete, dhe është në fazën e diskutimit nen për nen.

Në fund, kur të vijmë në diskutimin dhe miratimin nen edhe të kësaj pakete, të dyja nismat do të bashkohen në një, dhe e gjithë paketa e ndryshimeve në Kodin Penal, ku përfshihet edhe mbrojtja e kafshëve, që fatmirësisht, këtë radhë është edhe iniciativë e një grupi qytetarësh apo ambientalistësh, të cilët, le të themi, monitorojnë çështjet e mjedisit, do të jetë pjesë e paketës që do të votohet në seancë plenare.

Tani, lidhur me kuorumin e nevojshëm për ta kaluar këtë paketë në seancë plenare. Po, është e vërtetë: është ligj i cilësuar, kërkon 84 vota. Ne shpresojmë e besojmë se gjatë diskutimeve, qoftë në parim, qoftë nen për nen, në Komisionin e Sigurisë, në Komisionin e

Veprimtarive Prodhuese, në Komisionin e Ligjeve, edhe kolegët e opozitës do të bëhen pjesë e kësaj pakete, duke i dhënë votën pro. Unë besoj se nga garantimi i sigurisë ushqimore, sigurimi i mjedisit, i jetës dhe i shëndetit të qytetarëve, por pse jo edhe i mbrojtjes së kafshëve, jemi të fituar që të gjithë. Askush nuk humbet.

Ka qenë një kërkesë e vazhdueshme e profesionistëve të shëndetit, që të depenalizohet mjekimi i pakujdesshëm, sepse e ju e dini se nga zbatimi në praktikë i mjekimit të pakujdesshëm, ne kishim pa fund mjekë e infermierë, të cilët i nënshtroheshin kësaj dispozite, por është tjetër gjë gabimi mjekësor, është tjetër gjë neglizhenca në trajtimin mjekësor.

Ne e kemi depenalizuar gabimin mjekësor, por sigurisht, në ndryshimet e propozojmë kemi parashikuar neglizhencën në trajtimin mjekësor.

Nuk e di nëse isha i qartë.

Shumë faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit edhe një herë zoti Manja!

Në fakt, do të më duhet t'i jap fjalën zotit Maliqi, e më pas zotit Zeneli.

Lefter Maliqi – Faleminderit, zonja kryetare!

I nderuar zoti Manja!

Faktikisht këto ndryshime dhe ky pothuajse shtrëngim i këtyre neneve të Kodit Penal, për sa u përket kundërvajtjeve penale apo veprave penale, sigurisht që ka një efekt psikologjik dhe parandalues. Në parim, unë jam dakord, e madje kam qenë dakord që të ishin bërë edhe vite më parë, për shkak se i gjithë opinionin publik e di se kanosja, fyerja, kërcënimi apo veprat e rënda si plagosja, që mund të ketë pasojë edhe vdekjen, ndaj bluzave të bardha, ndaj organeve të drejtësisë, ndaj Policisë së Shtetit, ndaj rrezikimit të jetës nga ushqimet e skaduar e të tëra me radhë, apo edhe në aktivitete të ndryshme sportive, ka qenë diçka evidente dhe shumë problematike në vendin tonë.

Megjithatë, unë mbetem në një linjë me zotin Murrizi: pse në këtë kohë, pse me kaq ngut këto ndryshime? Ne jemi edhe para zgjedhjeve lokale, dhe unë shoh këtu një nen, që nuk e di se çfarë lidhje ka: goditjet apo veprat e tjera të dhunës ndaj punonjësve që kryejnë një detyrë shtetërore apo një shërbim publik dënohet nga kaq deri në kaq, por nëse kjo vepër kryhet në mjediset e institucionit, në të cilin personat ushtrojnë detyrën shtetërore, dënohet më rëndë.

Meqenëse jemi para zgjedhjeve lokale, unë e quaj të ngutshme. Nuk e di nëse kjo ka lidhje apo jo, sepse edhe vëzhguesit, edhe komisionerët bëjnë një detyrë publike apo

shtetërore. Për shkak se opozita nuk merr pjesë në zgjedhje, e nëse zgjedhjet bëhen, mund të ketë edhe incidente, dhe këto janë masa shumë shtrënguese.

Unë jam dakord që këto të ishin bërë me kohë, jo në situatën që është krijuar kohët e fundit, kur maxhoranca thotë se do të vemi në zgjedhje pa garë, ndërkohë që të gjithë e dimë se në çdo ndeshje, kur ndodhin konfrontime dhe probleme të tilla, ka rivalë, por në gjysmën e bashkive nuk ka rivalë. Pra, unë e mendoj të shpejtë, për shkak të situatës në të cilën ndodhemi, e shoh si presion edhe ndaj opozitës aktuale. Shpresoj dhe besoj të ketë një marrëveshje, të kalojnë në zgjedhje të dyja palët, por e shikoj të arsyeshme këtë ndërhyrje për shkak se edhe vet si ish-drejtues vendor, ish-drejtues policie, por edhe si politikan e kam shprehur dhe e them, që zgjedhjet do të bëhen, por edhe mund të mos bëhen, edhe në qoftë se do të bëhen, do të ketë ndryshime dhe nuk besoj që këto ndryshime të shpejta të kenë një efekt më shumë për ta motivuar dhe nxehur edhe më keq situatën, ndërkohë që ju mendoj se mund të ketë efekt parandalues, unë mendoj efektin tjetër ndaj opozitës.

Në parim jam dakord, duhet të ishin bërë me kohë, i shërbejnë vendit, punonjësve të shtetit, gjithë aktiviteteteve dhe sigurisë së jetës së tyre, por për momentin unë e quaj të nxituar.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Faleminderit, zoti Maliqi!

Zoti Manja, besoj se ka një përsëritje të pyetjes, por, sidoqoftë, ka një insistim në arsyen përse duhen bërë tani këto ndryshime.

Ulsi Manja – Së pari, zoti Maliqi, ju falënderoj për votën pro në parim të këtyre ndryshimeve!

E vlerësoj shumë votën tuaj, sepse një votë pro në parim, do të thotë një premisë për një votë pro edhe në seancë plenare.

Lidhur me kohën, nuk ka lidhje me zgjedhjet e 30 qershorit, sepse paketa që ne sjellim sot ka kohë që ka nisur të diskutohet për të ardhur në Kuvend. Janë problematika e thatë edhe ju, që do të duhej të ishin adresuar me kohë në Kodin Penal. Koha erdhi tani, por fakti që kemi zgjedhjet e 30-qershorit përpara, është një rastësi. Nëse do të arrihet të miratohet dhe të hyjë në fuqi edhe para zgjedhjeve të 30-qershorit, pse jo, do të ishin një garanci shtesë në drejtim të garantimit dhe mbarëvajtjes së procesit elektoral.

Ju bëtë një pyetje më parë (në fund të fundit, njerëz politikë jemi) nëse do të ketë apo jo zgjedhje në qershor, nëse do të ketë dhunë apo jo, natyrisht që do të ketë zgjedhje më 30 qershor, sepse na detyron Kushtetuta. Nëse do të ketë dhunë, përplasje apo konflikte, ju garantoj që nuk do të ketë asgjë nga këto, sepse paketa e Kodit Penal që kemi sot është e

plotë dhe i parashikon të gjitha këto situata. Fatmirësisht, e kemi votuar me konsensus të plotë edhe me opozitën, që sot ka dalë në rrugë.

Shqiptarët janë popull i mençur, janë shumë hapa para klasës politike dhe nuk besoj se për karrigen time, të kolegut Shameti apo të dikujt tjetër të jenë të gatshëm të sakrifikojnë veten me vite burgu, për të garantuar karriget e politikanëve shqiptarë. Në këtë kuptim, këtë paketë nuk e shoh të lidhur me zgjedhjet e 30-qershorit, sepse, po ta kishim këtë shqetësim do të kishim ardhur ndoshta me ashpërsim masash dënimi për sa u përket dispozitave që ka Kodi Penal për sistemin e zgjedhjeve të lira dhe demokratike. Jo, për ne Kodi Penal, në atë drejtim, është i plotë. Pastaj, në çdo kohë, situatë apo proces zgjedhor, i nderuar koleg, ka pasur njerëz që kanë zgjedhur të konfliktohen me ligjin penal dhe kanë marrë edhe ndëshkimet përkatëse.

Kështu që unë 30 qershorin e shoh një proces normal.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Fjala për zotin Shameti.

Adnor Shameti – Faleminderit, zonja kryetare!

Doja të shtoja diçka në lidhje me konstatimet e zotit Maliqi: në radhë të parë, shpreh vlerësimin për votën pro për miratimin në parim të kësaj pakete ligjore që prezantojmë sot!

Dua ta siguroj zotin Maliqi që procesi ligjbërës për këtë paketë ndryshimesh në Kodin Penal do të marrë të gjithë kohën e nevojshme. Unë nuk shikoj asnjë lloj paraleleje midis datës së zhvillimit të zgjedhjeve lokale dhe procesit normal legjislativ dhe gjithë vëmendjes së duhur, konsultimit dhe analizës midis grupeve të punës dhe komisioneve parlamentare këtu, me qëllim që të gjithë kolegët e nderuar të opozitës ta kenë të gjithë kohën e nevojshme për të shprehur bindjen e tyre duke mirëpritur çdo vërejtje dhe sugjerim, që drafti i paraqitur, ashtu sikurse e përmendët ju, zonja kryetare, t'i rezistojë kohës dhe të mos ketë nevojë për t'u amenduar në të ardhmen.

Faleminderit!

Ermonela Felaj - Gjithsesi, mund të bënim edhe dy konstatime të natyrës shumë praktike. Koha fizike nuk premtonte që këto ndryshime të hyjnë në fuqi para zgjedhjeve, në çdo rast do të hyjnë në fuqi pas tyre, sikundër ju, edhe unë dhe të gjithë këtu e dimë që ligji penal nuk ka fuqi prapavepruese, kështu që janë thjesht nevojat e konstatuara në praktikë ato që kanë çuar në idenë e propozimit të këtyre ndryshimeve.

Nëse ka diçka tjetër nga ana juaj, zoti Maliqi...

Lefter Maliqi – Pothuajse ishte kjo që tha kryetarja, unë në parim jam dakord, por e kisha për efektet mbas 30 qershorit.

Ermonela Felaj - Më duhet t'ia jap fjalën nënkryetarit, zotit Zeneli.

Alban Zeneli – Faleminderit, zonja kryetare!

Në radhë të parë, te projekt-kodi që vjen në Komisionin e Sigurisë, të gjitha pikat që janë parashtruar këtu, kur janë në interes të qytetarëve shqiptarë, në aspektin formal jemi të gjithë dakord, por unë vërej që maxhoranca në vazhdim e saj 6-vjeçare të arrogancës që ka treguar jo vetëm ndaj qytetarëve, por edhe ndaj këtij komisioni, duke qenë se është një Kod dhe duhen vota të cilësuar, minimumi, në respekt edhe të asaj që do të kalojë për votim në parlament, duhet të ishte konsultuar edhe me pjesën tonë të opozitës, meqenëse kërkon edhe votat tona.

Vë re se kjo nuk ka ndodhur dhe për këtë shkak jemi absolutisht kundër në parim, pavarësisht se shumica e pikave janë në interes të qytetarëve. Kur ju ta keni me të vërtetë seriozisht që keni përfshirë qytetarët në radhë të parë, gjithashtu, të jemi të përfshirë edhe ne në dhënien e mendimeve dhe opinioneve tona lidhur me të gjitha pikat që janë aty, atëherë absolutisht edhe ne do të jemi dakord me të gjithë projektligjin që keni paraqitur.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Fjala për zotin Braho.

Spartak Braho – Së pari, gjykoj që Kodi ose ndryshimet e propozuara nga një grup deputetësh të jenë pjesë e shqyrtimit edhe nga ana e Drejtorisë së Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë.

Nuk e di, Ulsi, në qoftë se kanë kaluar, por ne kemi Drejtorinë e Kodifikimit, e cila bën rregullimin jo vetëm në përmbajtje, por edhe në pikëpamjen e teknikës legjislative. Për shembull, fjala “neglizhenca” nuk më pëlqen, “neglizhencë” do të thotë pakujdesi. Ardhja e këtij Kodi është pjesë e problematikës, është objektivisht, dhe ne si maxhorancë detyrohemi që t'i sjellim këto ndryshime duke kërkuar natyrisht okey-in dhe fjalën e opozitës, në qoftë se i vlerëson si të domosdoshme edhe për faktin që Kodi do 84 vota që të miratohet.

Unë do të dëshiroja që këto dispozita të hyjnë në fuqi para zgjedhjeve. Nuk e di çfarë llogarish keni bërë, por kjo gjë duhet bërë kështu, sepse problematika lidhet edhe me zgjedhjet. Në një kohë që Kryeministri thotë që ky do të dënohet kaq, ky kaq, domethënë ai e ka problem. Ai nuk është vetëm Kryeministër, por është edhe kryetari i maxhorancës. Nuk e di si bëhen llogaritë, s'jam ndalur të bëj llogari për hyrjen në fuqi, por mirë është të hyjë në fuqi para zgjedhjeve.

Faleminderit!

Ermonela Felaj – Faleminderit, zoti Braho!

Më falni, zoti Manja, që po bëj këtë ndërhyrje!

Do të doja t'i nxisja të gjithë kolegët që jemi këtu të ruanim një qëndrim të rezervuar në kuptimin që të mos ua mbyllim dritën jeshile ndryshimeve të propozuara për faktin se ky është një propozim dhe, normalisht, propozimi që vjen nga një deputet nuk është i kushtëzuar që ti duhet të marrësh mendimin e këtij apo atij, por është një propozim që bëhet mes kolegësh thjesht dhe vetëm për këtë arsye duhet parë pozitivisht. Mandej, gjatë diskutimeve nen për nen që do t'i kemi të veçanta, të ruajmë edhe qëndrime ku ne mendojmë që gjëja nuk përputhet me nevojën është e tepruar, nuk është momenti që ne ta bëjmë këtë ndryshim.

E them këtë, sepse kam parasysh se të paktën sa u takon ndryshimeve të propozuara për pjesën e mbrojtjes së mjedisit, për to është punuar shumë më herët. Për shkak të këtyre dakordësive që nuk kishin të bënin me thelbin, por me projektimin e një shumice të caktuar, ose jo, këto ndryshime nuk kanë ndodhur.

Në një kohë që ne Kodin Penal e kemi realisht shumë të vjetër, që nga viti 1995, për sa u takon veprave penale që mbrojnë mjedisin, edhe në këto dispozita nuk është bërë asnjë lloj ndryshimi.

Të njëjtën gjë mund ta them edhe për pakujdesinë që i takon mjekimit shëndetësor. Është një vepër shumë delikate, në fakt. Në gjykimin tim, problematika ka ardhur më tepër për moszbatimin si duhet të ligjit, se sa të shkrimit të ligjit, megjithatë, në qoftë se është kjo problematikë, le të përpiqemi ta shkruajmë ligjin qartë dhe të mbrojmë njerëzit, në radhë të parë, jetën dhe shëndetin e tyre që ata të mos bëhen viktimë të mjekëve apo infermierëve të papërgjegjshëm, sepse, normalisht, neglizhenca është një formë e pakujdesisë, pakujdesia është faj në vetvete dhe është e dënueshme, sikundër edhe “dashja”, pavarësisht se dënohet në një shkallë më të ulët. Pra, edhe kjo është një gjë që ia vlen ta shohësh, sikundër, të njëjtin gjykim mund ta ruajmë edhe për vepra të tjera.

Do t'ju ftoja që të paktën t'ia hapim rrugën në parim (ne nuk jemi të 140 deputetët këtu), sepse rrugëtimin e këtyre ndryshimeve nuk e vendos fati i këtij votimi, mandej, në diskutimin nen për nen, të ruajmë ato gjykime dhe mendime që kemi secili të pakushtëzuara.

Në fakt, është një moment i rëndësishëm, është folur kaq herë, të paktën sa kohë kemi ne këtu si shumicë në parlament, majtas dhe djathtas për një Kod të ri Penal dhe asnjëherë nuk është bërë, ndoshta edhe për faktin se duket që është një angazhim shumë i madh, duket që është e vështirë të gjesh konsensusë kaq të mëdha në kohë kaq të shkurtër, por për disa ndryshime që ne si njerëz, si qytetarë e kuptojmë edhe vet që janë të nevojshme

dhe duhen bërë, le t'i shikojmë ato dhe të mundohemi ta gjejmë gjuhën e përbashkët dhe t'i bëjmë këto ndryshime në ligj.

Zoti Manja, fjala për ju.

Ulsi Manja – Në fakt, duke falënderuar të gjithë kolegët e komisionit për natyrën konstruktive të debatit, qoftë të pyetjeve, qoftë të sugjerimeve bashkohem plotësisht edhe me sugjerimin e kryetares, zonjës Felaj, që sot jemi këtu para jush për të kërkuar votën në parim për këtë paketë ndryshimesh, por jemi plotësisht të hapur si grup nismëtar, pse jo, që kjo paketë t'i nënshtrohet një diskutimi dhe konsultimi të gjerë dhe të hapur edhe mes kolegësh.

Janë tri komisione të Kuvendit që janë përfshirë në shqyrtimin dhe miratimin e këtij projektligji: Komisioni i Sigurisë, një komision shumë i rëndësishëm për sa i përket pothuajse 80 % të ndryshimeve të kësaj pakete që sugjerohet; Komisioni i Veprimtarive Prodhuese, që do të japë ekspertizën e vetë për sa u përket ndryshimeve që propozohen për sigurinë mjedisore dhe ushqimore, dhe Komisioni i Ligjeve si komision përgjegjës, që në përfundim do të bëjë bashkimin e të gjithë paketës me sugjerimet dhe vërejtjet e komisioneve përkatëse dhe të ekspertëve përkatës.

Kështu që mendoj, kolegë deputetë (bashkohem ose i jap përgjigje në një farë mënyrë edhe shqetësimit të kolegut Zeneli) që absolutisht nuk ka qenë qëllim për të përjashtuar askënd nga kolegët për diskutimin e kësaj pakete. Ne jemi të hapur deri në fund për të gjithë kolegët e opozitës.

Paketa fillon sot në këtë komision dhe ky komision e ka ekspertizën e duhur për të dhënë sugjerime për një pjesë të rëndësishme të ndryshimeve që ne propozojmë në ditët në vazhdim të Komisioni i Veprimtarive Prodhuese dhe të Komisioni i Ligjeve, kështu që me shumë dashamirësi do t'i ftoja të gjithë kolegët e këtij komisioni (është shumë i rëndësishëm mesazhi që përcillet sot nga ky komision, që ka filluar i pari me shqyrtimin e kësaj pakete), që ne si maxhorancë, por, pse jo edhe si parlament, t'u japim përgjigjen e duhur në kohë këtyre problematikave shumë të rëndësishme në jetën e qytetarëve, qoftë për sa i përket mbrojtjes së një kategorie të caktuar të nëpunësve publikë dhe funksionarëve, profesionistëve shëndetësorë, sigurisë ushqimore, sigurisë mjedisore, sepse, në fund të fundit, këto janë shqetësimet e një qytetari të zakonshëm në Shqipëri, edhe tonat, si deputetë.

Sot, së bashku me kolegun Shameti, në emër të nismëtarëve, janë 11 kolegë që e kanë formalizuar këtë nismë, kërkojmë votën tuaj për ta mbështetur në parim këtë paketë.

Këtu dua mbyll fjalën time.

Faleminderit për durimin dhe mundësinë që na dhatë sot për prezantimin e paketës!

Ermonela Felaj – Faleminderit!

Besoj se mund ta mbyllem këtë diskutimin dhe pyetjet formale sa i takon shqyrtimit në parim të kësaj çështjeje.

Po, zoti Murrizi.

Myslim Murrizi - Lidhur me atë që parashtrova në fillim kur pyeta kolegët e mi, që janë ndër 11 firmëtarët iniciues të ndryshimeve pjesore të Kodit Penal, vë re se fakti që në 29 vjet post-komunizëm Kushtetutën e vendit e kemi ndryshuar 3 herë, në vitet 1998, 2008 dhe 2016, fakti që Kodi Penal nuk është ndryshuar që nga viti 1995, pra për 24 vjet, tregon më së qarti se elitat vendimmarrëse të këtij vendi nga të gjithë krahët politike nuk kanë dashur që të ketë një Kod Penal frenues për të gjitha veprat që në vetvete, në këtë vend, janë tagër i politikanëve të lartë, të mesëm, që kanë qeverisur Shqipërinë nga 31 marsi i vitit 1991 deri më sot.

Kur ka ardhur puna, Kushtetuta e këtij vendi është ndryshuar me telefon për 10 minuta për interesat e atyre që kanë hipur në “kalin e pushtetit”, siç ka ndodhur në prill të vitit 2008. Pengesat, gjoja, apo vështirësitë, që nuk paska pasur kohë për të hartuar një Kod Penal gjatë 25 vjetëve, janë justifikime, absolutisht. Duhet të jemi të hapur dhe të qartë me qytetarët shqiptarë, se të gjitha palëve që kanë qeverisur Shqipërinë në këto 29-vjet post-komunizëm nuk u ka ardhur mirë që të kishin një Kod Penal ashtu siç e kanë vendet e BE-së dhe ku ne aspirojmë të shkojmë si vend.

Sa për ngutjen, apo atë që deklaroi kolegu Braho se do ta bëjmë, se Kryeministri ka disa ditë që thotë se këtë do ta fusim kaq vite në burg, këtë aq (si rast, se unë nuk di të ketë përmendur emra) tregon më së qarti se në gjendjen aktuale qeverisemi nga një politikë autokrate, ku Kryeministri kërkon të imitojë regjimin e kaluar para 29 vjetësh, ku pretencën e jep ai që është në qeveri, Sekretari i Parë dhe thotë: “kaq burg këtu, kaq burg këtu”. Burgjet nuk i bën dot Kryeministri, aq më shumë që ne kemi kohë që mburremi me vetingun dhe reformën në drejtësi, kemi një drejtësi që po bëhet e mirë, e re, e bukur sipas organeve vetinguese, burgun do ta japin ata prokurorë dhe gjyqtarë të drejtësisë së re pasi të kalojnë vetingun, dhe nuk besoj ta japë Kryeministri.

Duke parë ngutjen tuaj dhe duke mos pyetur fare për votat tona, mbase nga përvoja e blerjes së votave në kuti nga viti 2005 e këtej, mendoni se mund t’i blini votat edhe brenda sallës së Kuvendit për ta kaluar këtë paketë ndryshimesh të Kodit Penal, kjo është puna juaj si maxhorancë, por fakti që kërkohet edhe vota jonë, që të jetë 84, pse jo, 104, 114, nëse realisht ka një konsensus edhe gjatë kohës që diskutohet, atëherë do të doja që ta kundërshtoja zonjën

Felaj, jam dakord me zotin Braho që ky ligj jo vetëm të hyjë në fuqi para zgjedhjeve, por ta kalojmë shpejt të enjten dhe të premten të hyjë në fuqi, që t'i fusim në kokërr të burgut ata që dalin në protestë ditën e shtunë, kudo që qëllojnë të vijnë vërdallë, o në Unazë, o rreth e qark Kryeministrit.

Ndërsa...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po, po, shkurt, ta heqim atë pikën ku thuhet: “Hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare”. Unë, në fakt, jam dakord të hyjë në fuqi të premten në darkë, që ata që sillen vërdallë të hyjnë në burg të shtunën në mëngjes, madje unë mendoj të ketë edhe efekte prapavepruese që të pastrojmë politikën shqiptare nga hartuesit e parë të çadrave të hartuesit i çadrës së lirisë dhe bilbilfryrësit që i zunë rrugën kryetarit të qarkut të Fierit, Vasil Ndreko, madje të ikë gjysma e Kuvendit, se këtu janë ata që dilnin me tamtame dhe bllokunin rrugët. A doni t'i bëjmë nder Shqipërisë? I japim 10 vjet fuqi prapavepruese, e miratojmë me procedurë të përshpejtuar, të hyjë në fuqi të enjten dhe ditën e shtunë të biem rehat edhe ne, edhe ju, sepse nuk do të ketë protestë më.

Xhemal Qefalia – Unë nuk kisha në mend të diskutoja, por duke marrë shkas nga diskutimi i kolegut, më vjen habi që nuk ka një sensibilitet pozitiv lidhur me dhunën që përdoret ndaj mjekëve. Ky është ligj, ky është kod që ndihmon mjekët dhe infermierët të mos dhunohen. Ky është ligj që e kanë shumë vende të tjera të përparuara me qëllim që në sport të mos hyhet me pistoletë në fushë, të mos goditen lojtarët. Unë i jam referuar ligjit penal anglez se sa është dënimi për ata që dhunojnë lojtarët në fushë, referojuni edhe ju po deshët. Nëse ju thoni se ky ligj nuk duhet miratuar dhe ndryshimet në Kod nuk duhen miratuar, në fakt, po iu thoni qytetarëve shqiptarë të vazhdojnë të marrin ushqime të skaduara ose produkte që dëmtojnë shëndetin, atyre që luajnë me lojërat e fatit të vazhdojnë ta ushtrojnë këtë veprimtari, edhe pse është e ndaluar me ligj.

Pra, po ta shikoni në këtë këndvështrim, ju nuk bëni gjë tjetër veç krijoni imazhin që nuk doni t'i miratoni. Është mundësia që edhe sot të kalojë në parlament ky projektligj që mjekët të jenë të garantuar, që familjet shqiptare të mos jenë të kërcënuara nga siguria ushqimore.

Prandaj, unë mendoj ta lëmë debatin politik në seancën parlamentare dhe t'i falënderojmë kolegët për këtë nismë shumë të mirë dhe në kohën e duhur!

Ermonela Felaj- Këtu mbyllen diskutimet.

Do të vazhdojmë me votimin në parim të ndryshimeve të propozuara. Ne jemi sot këtu për të bërë diçka dhe kemi detyrimin ligjor edhe si të zgjedhur të ndjekim të gjitha fazat dhe procedurat ligjore pa tejkalar asgjë, sepse një ligjshmëri, ose nevoja për të vendosur, ose për të bërë ligjshmëri nuk mund të justifikohet me paligjshmëri.

Kush është dakord me ndryshimet e propozuara në ligjin “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar”, nismë e një grupi deputetësh? Kundër? 2 kundër. Abstenim? Nuk ka.

Miratohet.

Faleminderit!

Do të njoftoheni për mbledhjen e ardhshme.

MBYLLET MBLEDHJA